

Dr. Getoar Mjeku, jur.
Rr. Enver Maloku, nr. 110
10000 Prishtinë
+383 45 30 52 00
gm@getoar.com

GJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS
DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

lidhur me lëndën **A. nr. 3090/19**

Paditës-propozuesi:

Sami Kurteshi, rr. Xhavit Ahmeti, nr. 9/A, 10000 Prishtinë
përfaqësuar me autorizim nga juristi Getoar Mjeku

ndaj të paditur-kundërpropozueses:

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë) e Republikës së Kosovës
rr. Dervish Rozhaja, nr. 12, 10000 Prishtinë

PARASHTRESË

sipas ligjit:

Ligji për procedurën kontestimore, 03/L-006, ndryshuar, neni 99

lidhur me:

Rishqyrtimin e kërkesën për shtyrje të ekzekutimit

Paraqitur për paditës-propozuesin
Prishtinë, 5 mars 2020

1. Më 24 dhjetor 2019, paditës-propozuesi Kurteshi ka parashtruar padi ndaj një vendimi të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE), duke kërkuar edhe shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Gjykata Themelore e Prishtinës ka miratuar kërkesën me Aktvendimin e 27 dhjetorit 2019.
2. Më 20 shkurt 2020, Gjykata e Apelit ka prishur Aktvendimin e 27 dhjetorit 2019. Kështu Apeli ka pranuar si të themelta ankesat e të paditur-kundërpropozueses ZRrE dhe të dy palëve të interesuara, dhe ka kthyer çështjen në rishqyrtim.
3. Paditës-propozuesi Kurteshi kërkon Gjykatës së nderuar që në këtë rishqyrtim të rivendosë shtyrjen e ekzekutimit.
4. Aktvendimi i Apelit përmend vetëm një nga tri përgjigjet e paditës-propozuesit në ankesat e palëve kundërshtare. Gjithashtu, cek se në shkresat e lëndës nuk ka prova me mbështetë shtyrjen e ekzekutimit.
5. Këto konstatime të Apelit na japin shkas për t'u siguruar se Gjykata e nderuar ka në dispozicion të gjitha parashtresat e paditës-propozuesit.
6. Për këtë arsye, kësaj parashtrese po i bashkëngjesim kopjet e parashtresave si vijon:
 - (1) Padi për konflikt administrativ dhe kërkesë për shtyrje të ekzekutimit, e 24 dhjetorit 2019, me 26 faqe dhe 14 shtojca
 - (2) Përgjigje në ankesën e të paditur-kundërpropozueses ZRrE, 30 janar 2020, me 8 faqe
 - (3) Përgjigje në ankesën e palës «Building Construction L.L.C.», 13 shkurt 2020, me 9 faqe
 - (4) Përgjigje në ankesën e palës «Alsi & CO – Kosovë L.L.C.», 21 shkurt 2020, me 10 faqe
7. Veçanërisht, i tërheqim Gjykatës vëmendjen ndaj shtojcave 4 dhe 5 të padisë dhe kërkesës fillestare, për të vënë re dëmin që vendimi i së paditurës u shkakton paditës-propozuesit dhe konsumatorëve të tjerë të rrymës.
8. Argumentet në mbështetje të shtyrjes janë elaboruar si në padinë dhe kërkesën fillestare ashtu dhe në tri përgjigjet ndaj ankesave.

9. Për të lehtësuar menaxhimin e dosjes së lëndës, këtë parashtresë dhe bashkëngjitjet po i lidhim në formë të librit.
10. Rrjedhimisht, paditës-propozuesi i kërkon Gjykatës Themelore të rinxjerrë Aktvendimin e 27 dhjetorit 2019.

**Përfaqësuesi i paditës-
propozuesit:**

Dr. Getoar Mjeku, jur.
Rr. Enver Maloku, nr. 110
10000 Prishtinë
+383 45 30 52 00
gm@getoar.com